

Përmbledhës metodologjik mbi matje të inflacionit bazë në Shqipëri

Evelina Çeliku

Dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

- I. Përgjigje për disa pyetje mbi inflacionin bazë**
- II. Matjet dhe vlerësimet e inflacionit bazë në Bankën e Shqipërisë**
- III. Analizë krahasuese e matjeve të inflacionit bazë**
- IV. Referenca**

I. Përgjigje për disa pyetje mbi inflacionin bazë

a. Çfarë tregon inflacioni bazë?

Inflacioni bazë është përbërësi i inflacionit total që tregon prirjen themelore dhe më të qëndrueshme të inflacionit.

b. Cili është ndryshimi kryesor ndërmjet inflacionit total dhe inflacionit bazë?

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), i llogaritur dhe i publikuar nga INSTAT-i, shërben për të matur *inflacionin total*. Pra, inflacioni total pasqyron ndryshimet në koston e jetesës, bazuar në luhatjet e çmimeve të të gjitha mallrave dhe shërbimeve të shportës së konsumit të një familjeje tipike shqiptare. Nga ana tjetër, *inflacioni bazë* është një përbërës i inflacionit total, i cili mat ndryshimin mesatar të çmimeve të konsumit, pasi nga shporta e IÇK-së përjashtohen artikuj me luhatshmëri të lartë çmimesh. Në këtë mënyrë, inflacioni bazë jep informacion mbi prirjen kryesore të çmimeve të konsumit, sepse përbërësit më të luhatshëm të IÇK-së janë përjashtuar. Inflacioni bazë përdoret shpesh si një tregues i prirjes afatgjatë të inflacionit. Prirja afatgjatë e inflacionit ndikohet kryesisht nga faktorë të kërkesës në ekonomi, të cilët, nga ana e tyre, ndikohen nga vendimet e politikës monetare.

c. Pse duhet të matet inflacioni bazë?

Inflacioni i matur nga IÇK-ja, shpesh ndikohet nga faktorë dhe goditje të përkohshme jashtë kontrollit të politikës monetare. Si pasojë e veprimit të faktorëve të tillë, shpesh të përkohshëm, si edhe të goditjeve të tjera afatshkurtra, vlerat e inflacionit mund të devijojnë në mënyrë të dukshme nga prirja kryesore ose nga objektivi i bankave qendrore për inflacionin. Ndonëse këto luhatje shuhen me kalimin e kohës, ato duhet të “veçohen” në mënyrën më optimale të mundshme nga komponenti më i qëndrueshëm i inflacionit, duke formuar kështu inflacionin bazë. Matja e inflacionit bazë ndihmon politikëbërësit të përcaktojnë nëse luhatjet në çmimet e konsumit janë tranzitore apo janë pjesë e një tendence më të përherëshme. Ky informacion i gjeneruar nga inflacioni bazë është shumë i rëndësishëm në formulimin e politikës monetare, e cila vendimmarrjen nuk e mbështet në luhatjet afatshkurtra, por në ecurinë në afat të mesëm të inflacionit, e përcaktuar nga faktorët e kërkesës.

d. Cilat janë luhatjet afatshkurtra më të zakonshme që duhen “veçuar apo izoluar” nga inflacioni bazë?

Natyra e luhatjeve mund të jetë e rregullt, si në rastin e sjelljeve sezonale të çmimeve. Subjekt i luhatjeve sezonale janë në pjesën më të madhe të rasteve çmimet e produkteve ushqimore të papërpunuara, si ato të frutave dhe të perimeve. Krahas luhatjeve të rregullta, çmimet e disa artikujve të rëndësishëm të konsumit mund të jenë shumë të ndjeshme ndaj goditjeve, duke përjetuar norma të konsiderueshme ndryshimesh. Këto mund të shkaktohen nga luhatjet e forta të çmimeve jashtë ose nga vendime të brendshme administrative. Në rastin e parë, luhatjet lidhen me

mallra, çmimet e të cilave përcaktohen më së shumti në tregjet ndërkombëtare. Këtu përmenden çmimet e lëndëve të para dhe bazë, si ato të karburanteve. Në rastin e dytë, luhatjet lidhen me ato çmime që janë subjekt i vendimeve administrative të enteve të ndryshme rregullatore, si çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, në rastin e Shqipërisë. Luhatjet në çmime mund të pasqyrojnë edhe efekte nga vendime të autoriteteve fiskale, si në rastin e mallrave që janë subjekt akcize.

Zbulimi i përbërësit themelor të inflacionit – apo i inflacionit bazë - arrihet duke përjashtuar nga inflacioni total ndikimet e luhatjeve afatshkurtra, disa prej të cilave janë përmendur më lart.

e. Cilat janë metodat kryesore të llogaritjes dhe vlerësimit të inflacionit bazë?

Përjasjet për vlerësimin e inflacionit bazë janë të ndryshme dhe variojnë nga ato që përdorin teknika dhe tregues statistikore në ato që drejtohen nga vlerësime të modeleve ekonometrike.

Metoda më e zakonshme dhe më e përdorur në shumë vende është metoda me *përjashtim të përhershëm*. Kjo metodë llogarit inflacionin bazë, duke veçuar apo përjashtuar çmimet e një grupi fiks dhe të paracaktuar artikujsh nga shporta e IÇK-së. Komponentët e përjashtuar konsiderohen të kenë çmime me luhatshmëri të lartë ose të jenë të ndjeshëm ndaj paqëndrueshmërive nga goditjet e ofertës.

Metodat *statistikore me përjashtim të ndryshueshëm*, gjithashtu janë përjashtuese të artikujve që përjetojnë ndryshime ekstreme të çmimeve (si pozitive ashtu edhe negative) nga norma e përgjithshme e inflacionit. Por në metodat statistikore, grupi i artikujve të përjashtuar është i ndryshueshëm nga muaji në muaj, në varësi të artikujve që shfaqin luhatjet më të forta të çmimeve me kontribut të konsiderueshëm pozitiv ose negativ në inflacionin e përgjithshëm. Matjet më të përhapura të metodave statistikore të inflacionit bazë janë **mesatarja e reduktuar** dhe **e medianës**.

Në parim, renditen në rendin rritës ose zbritës ndryshimet mujore të indekseve individuale të çmimeve kombinuar me peshat respektive në shportën e IÇK-së. Pra, në themel të metodës qëndron renditja e kontributeve individuale në inflacionin e përgjithshëm për secilin muaj. **Mesatarja e reduktuar** llogarit normën mesatare të inflacionit, pas përjashtimit të një përqindjeje të caktuar kontributeve ekstreme negative dhe pozitive të çmimeve. Masa e përqindjes që përjashtohet në terma të numrit të artikujve të shportës, gjykohet pas një analize të rezultateve të koeficientëve të korrelacionit dhe të variancës. Kriteret statistikore që duhen plotësuar konsistojnë në: praninë e një koeficienti linear korrelacioni të lartë ndërmjet serive të inflacionit bazë me mesataren e reduktuar dhe inflacionit total; një volatilitet sa më të ulët të mundshëm të serive të inflacionit bazë.

Pavarësisht se numri i artikujve të përjashtuar të shportës së IÇK-së është i njëjtë në çdo muaj, artikujt mund të ndryshojnë dhe për rrjedhim, edhe peshat respektive janë të ndryshueshme nga njëri muaj në tjetrin. Kjo pasi edhe renditja e kontributeve mujore të inflacionit në rendin

rritës/zbritës është gjithashtu e ndryshueshme nga njëri muaj në tjetrin. Pas përjashtimit, llogaritet inflacioni bazë në çdo muaj si një mesatare e ponderuar mbi pjesën e mbetur të artikujve të shportës së IÇK-së, pasi shumën e peshave të artikujve të mbetur të shportës normalizohet në 1. Ndërkohë që përfaqëson **medianën** i korrespondon inflacionit të artikullit që i përgjigjet pozicionit të rreth 50 përqindëshit sipas peshave kumulative në IÇK, të renditura në një rend të caktuar. Statistikisht, mesatarja afatgjatë e serisë kohore të inflacionit bazë medianë duhet të jetë shumë pranë normës mesatare të inflacionit total. Kur devijimet e inflacionit medianë nga mesatarja e inflacionit total rezultojnë me anshmëri të rëndësishme, mund të korrektohen duke përdorur teknika statistikore shtesë.

Saktësia e metodave të mësipërme statistikore varet nga: shkalla e detajimit të të dhënave të IÇK-ve individuale; si dhe, kushti i pranishmërisë së një shpërndarjeje statistikore thuhet Normale të vlerave të inflacioneve/kontributeve të renditura. Ndërsa detajimi i të dhënave sigurohet nga institucionet statistikore përgjegjëse për matjen dhe publikimin e IÇK-së, kushti i normalitetit jo gjithmonë mund të plotësohet, duke dobësuar hera-herës saktësinë e treguesit përkatës.

Krahas metodave të mësipërme, përdoren edhe metoda të vlerësimit ekonometrik që mund të zbulojnë inflacionin bazë. Vlerësimet e modeleve ekonometrike verifikojnë lidhjet që duhet të rezultojnë statistikisht të rëndësishme midis inflacioneve individuale dhe variablave makroekonomikë kryesorë, si ai i hendekut të prodhimit. Modelet e vlerësuara të regresit përdoren për të evidentuar artikujt e shportës, inflacionet e të cilëve verifikojnë lidhjet e mësipërme, e si të tillë mund të përfshihen në nënshportën e llogaritjes së inflacionit bazë. Pra, përzgjedhja e artikujve bëhet përmes vlerësimit të modeleve ekonometrike, proces që me marrëveshje realizohet sipas një periodiciteti të caktuar. Kështu, kjo metodë nuk udhëhiqet nga gjykime paraprake në lidhje me natyrën e luhatjeve të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të shportës së IÇK-së dhe as nga peshat e tyre në këtë shportë, por nga fakti nëse inflacionet përkatëse janë ose jo të përcaktuara në mënyrë domethënëse nga hendeku i prodhimit apo të tjerë tregues përafrues të gjendjes ciklike të ekonomisë.

f. Cila është metoda më e përhapur nga bankat qendrore për matjen dhe publikimin e inflacionit bazë?

Monitorimi i inflacionit bazë është kthyer në një praktikë të zakonshme të bankave qendrore, pavarësisht regjimit të ndjekur të politikës monetare. Për rëndësinë që ky tregues ka në analizë dhe parashikim, pjesa më e madhe e vendeve publikojnë të paktën një seri të inflacionit bazë. Në shumicën e rasteve, janë bankat qendrore që llogarisin, vlerësojnë dhe publikojnë inflacionin bazë. Ato vendosin për seritë e inflacionit bazë që mund të publikojnë, me qëllim informimin e publikut të gjerë, në lidhje me prirjen më të qëndrueshme të inflacionit. Përvoja e pjesës më të madhe të bankave qendrore, me regjim të politikës monetare të “Inflacionit të shënjestruar”, zotërojnë të paktën një matje të inflacionit bazë. Metoda më e përhapur është ajo e “përjashtimit të përhershëm”. Artikujt që përjashtohen mund të ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, në varësi të specifikave të konsumit sipas vendeve. Vendet e zhvilluara, kur matin inflacionin bazë sipas përjashtimit të përhershëm, përjashtojnë gjithë grupin “Ushqime”, duke e konsideruar si një prej

“përgjegjësve” kryesorë të luhatjeve afatshkurtra të inflacionit. Në këto vende, ky grup zë një peshë mjaft më të ulët se sa në vendet në zhvillim, ku pesha e grupit “Ushqime” në shportën e IÇK-së është e lartë (duke arritur rreth 40%). Për rrjedhim, kontributi përkatës në inflacion është në përgjithësi i konsiderueshëm dhe përcaktues parësor për presionet inflacioniste. Përfundimi total i tyre në rastin e ekonomive në zhvillim, ku konsumi ushqimor zë peshë të lartë, do të dëmtonte besueshmërinë e treguesit të inflacionit bazë¹. Ndaj në këto vende, përjashtohen disa prej mallrave ushqimore, kryesisht të papërpunuara, me çmime shumë të luhatshme si: fruta-perime; mish e peshk i freskët etj. Gjithashtu, përjashtohen artikuj joushqimorë si: nafta, karburantet dhe energjia, çmimet e të cilëve varen nga koniunkturat e tregjeve ndërkombëtare; si edhe artikuj me çmime të administruara/rregulluara, çmimet e të cilëve vendosen dhe ndryshojnë sipas vendimeve të enteve rregullatore shtetërore etj.²

Metoda e mësipërme e përjashtimit të përhershëm është më e përhapur dhe më e preferuar për publikim, pasi është e thjeshtë për t’u kuptuar nga publiku, transparente, thjeshtësisht e replikueshme në llogaritje dhe më pak e kontestueshme në procesin e parashikimit të inflacionit të përgjithshëm. Megjithatë, ashtu siç është shpjeguar më parë, inflacioni bazë mund të llogaritet edhe me metoda të tjera që megjithëse janë më të sofistikuar, më pak të kuptueshme nga publiku dhe më të vështira për t’u replikuar, kanë përparësi në terma të analizës dhe të parashikimit. Në parim, të gjitha metodat, me përparësitë dhe dobësitë e tyre, duhet të përmbajnë informacionin bazë në lidhje me prirjen afatgjatë të inflacionit.

Në përfundim cilësohet se, inflacioni bazë është një tregues plotësues dhe si i tillë, nuk mund të zëvendësojë inflacionin e përgjithshëm. Ai është një komponent i inflacionit total që llogaritet apo vlerësohet nga bankat qendrore për të ndihmuar analizat dhe parashikimet në lidhje me natyrën dhe burimin e formimit të presioneve inflacioniste, qëndrueshmërinë e tyre aktuale dhe të pritshme.

II. Matjet dhe vlerësimet e inflacionit bazë në Bankën e Shqipërisë

Në Bankën e Shqipërisë janë zhvilluar alternativa të ndryshme për vlerësimin e inflacionit bazë, të cilat janë pjesë e metodave të shpjeguara në përgjigjen e pyetjes (e). Ato u shërbejnë analizave dhe parashikimit të natyrës dhe të intensitetit të presioneve inflacioniste në ekonomi dhe për rrjedhim të vendimmarrjes së politikës monetare. Në grupin e metodave të “përfundimit të përhershëm” janë zhvilluar disa përjasje, rezultatet e tre prej të cilave janë publikuar në seritë e inflacionit bazë. Në grupin e “metodave statistikore të përfundimit të ndryshueshëm” janë zhvilluar gjithashtu disa përjasje, dy prej të cilave janë publikuar. Në grupin e vlerësimeve ekonometrike janë zhvilluar vlerësime të regreseve lineare. Rezultatet e këtyre vlerësimeve kanë

¹Gill Hammond (2012), “State of the art inflation targeting”, Bank of England 2012 ISSN: 1756-7270 (Online) <https://www.bankofengland.co.uk/ccbs/state-of-the-art-of-inflation-targeting> pg. 10.

²https://www.bsp.gov.ph/Media_and_Research/Primers%20Faqs/inflation.pdf “Core inflation” (March 2020). Article: Department of Economic Research. Për më shumë detaje tabela ne faqen 4.

natyrë dinamike, pasi janë subjekt rishikimesh në varësi të variablave shpjegues në modele. Ato përdoren nga një rreth më i ngushtë ekspertësh në Bankën e Shqipërisë.

Seritë e publikuara të indekseve të inflacionit bazë llogariten nga Departamenti i Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë, pas publikimit të IÇK-së nga INSTAT-i. Disa nga seritë më të përdorshme të indekseve të inflacionit bazë me frekuencë mujore gjenden në: (https://www.bankofalbania.org/rc/doc/matje_te_inflacionit_baze_29262.xlsx).

Përmbledhje metodologjike

II.1. Metoda me “**Përrjashtim të përrhershëm**” është një ndër më të hershmet për llogaritjen e inflacionit bazë në Bankën e Shqipërisë. Duke qenë më e thjeshtë në llogaritje dhe interpretim, si dhe duke ofruar një transparencë të lartë për përdoruesit, kjo përqsasje është zhvilluar duke përrjashtuar në mënyrë të përrhershme disa artikuj të shportës, luhatshmëria e lartë e çmimeve të të cilëve, parimisht nuk duhet të ndikohet nga politika monetare. Alternativa të llogaritjes së inflacionit bazë sipas kësaj përqsasjeje janë përrfshirë vazhdimisht në Raportet e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë. Në vijim sqarohen dy prej përqsasjeve më të përrdorura:

- **II.1.a. Inflacioni bazë** - vlerësohet mbi atë pjesë të shportës së IÇK-së nga e cila përrjashtohen nëngrupet në vijim: fruta; perime; naftë dhe karburante; mallra akcize; mallra dhe shërbime me çmime të rregulluara. Në nënshportën e matjes së inflacionit bazë bëjnë pjesë edhe disa ushqime të përrpunuara dhe të rëndësishme për konsumin e familjeve shqiptare, të cilat, deri në fund të vitit 2021, përrjetuan një stabilitet relativisht të lartë të çmimeve përrkatëse. Goditjet në çmimet e këtyre produkteve gjatë vitit 2022, ndikuan gjithashtu në përrshpejtimin e inflacionit bazë sipas kësaj përqsasjeje. Përrsha e artikujve të përrjashtuar gjatë vitit 2024 është rreth 31%. Përr rrjedhim, inflacioni bazë është llogaritur mbi 69% të shportës së IÇK-së. Kjo përrshë është subjekt ndryshimi në çdo vit, pasi reflekton përrditësimin vjetor të shportës së IÇK-së³, edhe nëse artikujt e përrjashtuar do të mbeteshin të njëjtët.
- **II.1.b. Inflacioni bazë neto** – krahas përrjashtimeve në matjen (II.1.a.), inflacioni bazë neto përrjashton në mënyrë të përrhershme të gjitha ushqimet e përrpunuara që janë pjesë e saj. Përr rrjedhim, kjo matje e izolon tërrësisht inflacionin bazë nga ndikimet e luhatjeve të çmimeve të ushqimeve dhe bazohet në një nënshportë më të ngushtë që përrbën rreth 46% të shportës së IÇK-së për vitin 2024. Si e tillë, matja e inflacionit bazë neto përrfaqëson më së shumti inflacionin e formuar nga shërbimet dhe mallrat joushqimore me afat të gjatë përrdorimi.
- **II.1.c. Inflacioni bazë përrjashtuar ushqime dhe mallra energjetike** - është shumë i përrafërt me një prej matjeve neto të inflacionit të publikuar nga Eurostat nën emërrtimin

³ INSTAT-i përrditëson përrshat e konsumit në bazë të rezultateve më të reja të Anketës së Buxhetit Familjar dhe të llogarive kombëtare. Përrshat e përrditësuara publikohen me IÇK-në e muajit janar të çdo viti dhe mbeten të pandryshuara gjatë 12 muajve të vitit përrkatës.

“Inflacioni, përjashtuar mallra energjetike, ushqime, pije alkoolike dhe duhan”. Pesha e nënshportës përkatëse sipas kësaj matjeje për vitin 2024 është rreth 48%.

II.2. Metoda “Statistikore me përjashtim të ndryshueshëm” mbështetet në teknika dhe tregues statistikorë. Këtu bëjnë pjesë disa alternativa matjesh të përdorura në Bankën e Shqipërisë, shpjegimet e së cilave gjenden në vijim:

- **II.2.a. Inflacioni bazë, sipas alternativës së Mesatares së Reduktuar (30%).** Luhatjet më të forta pozitive dhe negative të kontributeve mujore të inflacionit në rastin e Shqipërisë, shkaktohen më së shumti nga ndikimi i faktorëve kalimtarë të çmimit përkatëse dhe që lidhen me sezonalitetin, me efektet e zbatimit të vendimeve të enteve rregullative në çmime (energji, ujë, barna mjekësore etj.), me goditjet në çmimet e produkteve të importuara çmimet e të cilëve varen nga koniunkturat ndërkombëtare (karburantet për mjetet personale të transportit) etj.
Sipas kësaj matjeje, përjashtohen 15% e artikujve të shportës që gjenden në skajin e sipërm dhe 15% në skajin e poshtëm të shpërndarjes së vlerave të renditura të ndryshimeve mujore të indekseve të çmimeve të artikujve të shportës të kombinuara me peshat respektive në shportën e IÇK-së. Më pas llogaritet një mesatare e ripeshuar e ndryshimit mujor të indekseve të çmimeve të 70% të numrit total të artikujve të mbetur të shportës, që janë të pozicionuar në zonën qendrore të shpërndarjes së kontributeve mujore. Pesha e nënshportës së inflacionit bazë sipas mesatares së reduktuar është e ndryshueshme në varësi të artikujve të mbetur pas përjashtimit. Mesatarja e saj për periudhën 2008-2024, që i përgjigjet 70% të numrit të artikujve, është rreth 55%.
- **II.2.b. Inflacioni bazë sipas Medianës së peshuar** është norma e inflacionit, e cila i korrespondon ndryshimit të indeksit të çmimit të përqindëshit të 50-të (bazuar në peshat e shportës së IÇK-së) në shpërndarjen e ndryshimeve vjetore të indekseve individuale të çmimeve në një muaj të caktuar. Kjo matje ndihmon në filtrimin e lëvizjeve ekstreme të çmimeve që lidhen me përbërës të veçantë. Ajo është vlera e inflacionit, ku gjysma e peshës së artikujve në shportë qëndron mbi të dhe gjysma tjetër qëndron nën të. Në këtë aspekt, mediana e peshuar është e ngjashme me mesataren e reduktuar, pasi përjashton ndryshimet e çmimeve në fundin më të ulët dhe më të lartë të shpërndarjes, duke lënë vetëm ndryshimin e IÇK-së së artikullit që ndodhet në mes të shpërndarjes.

II.3. Në metodën e “Vlerësimit ekonometrik” bëjnë pjesë përjasje nga më të thjeshtat në më të ndërlikuarat. Këto përjasje janë në proces zhvillimi në Bankën e Shqipërisë prej disa vitesh. Përjasjet e filtrimit të serisë kohore të inflacionit që synojnë eliminimin e luhatjeve afatshkurtra dhe zbulimin e prirjes kryesore apo të inflacionit bazë, janë aplikuar për qëllime kërkimore dhe parashikimesh. Ndërkohë, që pas vitit 2022, janë zhvilluar modele ekonometrike që synojnë të zbulojnë treguesit e inflacionit më të ndjeshëm ndaj kërkesës, hendekut të prodhimit dhe të treguesve të tjerë ciklikë.

III) Analizë krahasuese e matjeve të inflacionit bazë

Inflacioni i më shumë se dy dekadave të fundit në Shqipëri mund të analizohet sipas disa periudhave të dallueshme nga njëra-tjetra. Deri në fund të vitit 2011, inflacioni total do të rezultonte rreth objektivit 3%, në përgjigje të një aktiviteti ekonomik pranë rritjes potenciale (6%). Periudha 2012-2020 u karakterizua nga një inflacion i ulët dhe nën objektiv, ku si inflacioni total ashtu edhe ai bazë mesatar, do të rezultonin përkatësisht 1.8% dhe 0.8%. Inflacioni i ulët jo vetëm në Shqipëri, por edhe në nivel global, pasqyroi kryesisht zhvendosjen strukturore për poshtë të rritjes potenciale dhe të zhvillimeve thuajse anemike në tregun e punës dhe në paga, kundrejt dinamikave gjithashtu të dobëta të rritjes së produktivitetit⁴.

Periudha 2021-2023 u karakterizua nga prirje rritëse, me vlera të larta dhe mbi objektiv të inflacionit total dhe bazë, përkatësisht rreth mesatareve 4.5% dhe 3.6%. Përshpejtimi i inflacionit reflektoi fillimisht rikuperimin e kërkesës, pas lehtësimit të masave kufizuese nga Covid-19. Në vijim, lufta në Ukrainë ndikoi në rritjen e shpejtë të çmimeve, në pasqyrim të vështirësive me të cilat u ndeshën zinxhirët e prodhimit dhe të furnizimit. Presionet e huaja inflacioniste u intensifikuan nga rritja e çmimeve të lëndëve të para dhe të ushqimeve bazë në tregjet ndërkombëtare, të efektit zinxhir të tyre përmes rritjes së kostove prodhuese, të transportit, të shërbimeve dhe të rritjes së pritjeve inflacioniste.


Megjithëse në ngadalësim prej fundit të vitit 2022, inflacioni total dhe bazë mbetën në nivele të larta, pasi presionet inflacioniste nga kërkesa e brendshme ishin të forta. Ato pasqyruan persistencën e lartë, kushtet e shtrënguara të tregut të punës dhe rritjen e qëndrueshme të kërkesës. Në 9-mujorin e parë të vitit 2024, megjithëse në rënie graduale, inflacioni bazë ka dominuar formimin e inflacionit total (me rreth 75%).

Një vështrim krahasues mbi inflacionet bazë sipas metodave të ndryshme, gjatë periudhës 2021-2024. Alternativa të matjes së inflacionit bazë në Shqipëri - disa prej të cilave janë shpjeguar në seksionin II - tregojnë se, gjatë periudhës 2021-2024, inflacioni bazë ka qenë historikisht i lartë, sipas të gjitha përqasjeve të paraqitura në Grafik 1. Matjet sipas metodës me përjashtim të përhershëm përjetuan vlera veçanërisht të larta, ndërkohë që ato statistikore sipas mesatares së reduktuar (30%) dhe medianës së peshuar demonstrojnë një profil rritës, por më të zbutur. Kjo pasi ato eliminonin ekstremet e luhatjeve pozitive dhe negative të pozicionuara në skajet e shpërndarjeve të kontributeve të IÇK-ve individuale, duke mesatarizuar ato që gjendeshin në zonën qendrore të shpërndarjes. Të gjitha matjet përcillnin informacionin që presionet inflacioniste nga kërkesa në ekonomi ishin rritur ndjeshëm. Goditjet e ofertës nuk ishin të izoluara dhe të gjitha matjet e inflacionit bazë sinjalizonin për përcjelljen e gjerë të tyre te çmimet e konsumit. Disa prej matjeve paraqitën ndjeshmëri më të lartë, disa të tjera rritjen e morën me një profil më të zbutur, për shkak të veçorive në llogaritje dhe vlerësime.

⁴Më shumë analiza mbi prirjen e inflacionit të ulët në Shqipëri gjenden në studimin në vijim:
https://www.bankofalbania.org/Publications/Research/Research_Papers/Factors_behind_low_inflation_in_Albania_31665.html

Disa tregues statistikore të matjeve (Tabelë 1) zgjerojnë diskutimin mbi faktin që alternativa të ndryshme të inflacionit bazë duhen parë në këndvështrimin e informacionit që përcjellin për politikën monetare dhe për publikun, në periudha të caktuara kohore. Matja që përfshin disa ushqime të përpunuara⁵, aq sa u zgjerua shumë gjatë vitit 2022, u ngadalësua dukshëm më shpejt gjatë periudhës T1:2023-T3:24, krahasuar me matjet ku ushqimet janë të përjashtuara (inflacioni bazë neto dhe inflacioni bazë përjashtuar ushqime dhe energji). Këto të fundit paraqiten më pak volatile, ndërkohë që përfaqësojnë inflacionin e rreth gjysmës së mallrave dhe të shërbimeve të shportës së IÇK-së, me një korrelacion mesatar me inflacionin total (0.7). Matjet e tjera ku disa ushqime të përpunuara janë të përfshira, rezultojnë me korrelacion të fortë pozitiv me inflacionin total gjatë periudhës 2021-2024, korrelacion që luhet nga 0.93-0.97 dhe me volatilitet relativ të pranueshëm (60-80%), kritere këto të rëndësishme për përshtatshmërinë e matjeve të inflacionit bazë, veçanërisht në periudha inflacioniste.

Grafik1. Norma vjetore për matje të inflacionit bazë për Shqipërinë, 2009-2024 (majtas) dhe 2021-2024 (djathtas)



Burimi: Llogaritje dhe vlerësime të autores.

Tabelë 1. Tregues statistikore për matje të inflacionit bazë

2009 - 2024	Inflacioni bazë	Inflacioni bazë neto	Inflacioni bazë me përjashtim të ushqimeve e energjisë	Inflacioni bazë sipas mesatares së reduktuar	Inflacioni bazë sipas medianës së peshuar
Mesatare	1.8	1.2	1.2	1.2	1.3
Devijim standard	2.0	1.0	1.0	1.2	1.1
Koef. variance	1.1	0.9	0.9	1.0	0.8
Koef. korrelacioni	0.9	0.7	0.7	0.9	0.8


Burimi: Llogaritje dhe vlerësime të autores.

Një vështrim krahasues ndërmjet vendeve. Indeksi i çmimeve të konsumit që përjashton ushqimet, mallrat energjetike, kafe dhe pije alkoolike, për vende anëtare dhe candidate të BE-së (Eurostat), është shumë i ngjashëm në ndërtim me atë që shumë banka qendrore përdorin, si një alternativë matjeje për inflacionin bazë sipas përjasjes së përjashtimit të përhershëm. Për të

⁵ Inflacioni i këtyre ushqimeve para vitit 2021 ishte i qëndrueshëm në kohë.

shmangur diferencat në matje dhe për të krahasuar inflacionet bazë neto ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të rajonit e BE-së, janë marrë seritë e publikuara nga Eurostat⁶ (Grafik 2).

Grafik 2. Inflacioni bazë neto mesatar për periudhën 2019-T3:2024



Burimi: Eurostat.

Inflacioni bazë neto në Shqipëri rezulton pranë mesatares së vendeve në krahasim, deri në fund të vitit 2020. Vlerësimet krahasuese tregojnë se, pavarësisht diferencave nga njëra matje në tjetrën dhe nga njëri vend në tjetrin, tendencat e inflacionit bazë kanë qenë përshpejtuese, kryesisht gjatë periudhës 2021-2023, dhe gradualisht rënëse përgjatë vitit 2024. Kjo sjellje e inflacionit bazë në vend është e ngjashme me atë të ekonomive të tjera partnere.

Në përfundim të kësaj analize të shkurtër, të dalim në përfundimin që monitorimi i presioneve inflacioniste përmes alternativave të ndryshme të vlerësimeve të inflacionit bazë, është tashmë një trend i njohur për bankat qendrore. Po ashtu, nuk ka matje superiore ndaj të tjerave, pasi secila prej tyre, ka pikat e forta dhe të dobëta sipas periudhave kohore nëpër të cilat ecin ekonomitë, sipas veçorive të vendeve dhe sipas qëllimit të përdorimit të tyre, për analiza apo për parashikime. Pavarësisht diferencave, të gjitha përfaqesjet e inflacionit bazë konvergojnë në një qëllim: të mbështesin vendimmarrjen e politikës monetare të bankave qendrore, për të evidentuar më qartë intensitetin dhe qëndrueshmërinë e presioneve inflacioniste nga kërkesa.

⁶ Klasifikimi sipas qëllimit të COICOP: "Overall index excluding energy, food, alcohol and tobacco". Për të shmangur luhatjet brenda viteve, të dhënat paraqiten si mesatare vjetore të inflacioneve neto, për periudhën 2019-2023, dhe mesatare vjetore e tremujorëve të parë dhe të dytë të vitit 2024. https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/prc_hicp_midx_custom_9453410/default/table?lang=en

Referenca

<https://www.bankofengland.co.uk/ccbs/state-of-the-art-of-inflation-targeting>

https://www.bsp.gov.ph/Media_and_Research/Primers%20Faqs/inflation.pdf

https://ec.europa.eu/eurostat/databroëser/view/prc_hicp_manr_custom_8357200/default/table?lang=en;

https://www.ecb.europa.eu/pub/economic-bulletin/focus/2023/html/ecb.ebbox202305_05~84e89bcb5d.en.html

<https://www.imf.org/en/Publications/WP/Issues/2023/02/24/Weighted-Median-Inflation-Around-the-world-A-Measure-of-Core-Inflation-530171>

<https://www.oecd.org/economy/outlook/35022666.pdf>

<https://www.bankofcanada.ca/rates/indicators/key-variables/key-inflation-indicators-and-the-target-range/>

https://www.bsp.gov.ph/Media_and_Research/Primers%20Faqs/inflation.pdf “Core inflation” (March 2020). Article: Department of Economic Research.

https://www.bankofalbania.org/Publications/Research/Research_Papers/Factors_behind_low_inflation_in_Albania_31665.html